



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës**  
Z/znj \_\_\_\_\_

**Në bazë të dispozitave të nenit 44.1 pika Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.**

**F T O J**

Mbledhjen e dytë të rregulltë të K.K-së,s, e cila do të mbahet më **28.02.2018** (e mërkurë) duke filluar në ora **11:00**.

**R e n d i i d i t ë s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Raporti i Kryetarit për periudhen korrik-dhjetor 2017 ;
3. Shfuqizimi i Vendimit për formimin e Komitetit për Politik dhe Financa;
4. Formimi i Komitetit për Politik dhe Financa në pajtim me udhëzimin administrativ nr.03/2014;
5. Zgjedhja e antarëve të komitetit për komunitete në pajtim me udhëzimin administrativ nr.03/2014;
6. Formimi i Komisionit për verifikimin e kordinatave në terren;
7. Formimi i komisionit për emertimin e rrugëve;
8. Propozim (draft) rregullore për orarin e punës për biznese;
9. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

**Më: 16.02.2018**  
**Në: Novobërdë**



**Nebojsa Arsic**  
**Kryesues i Kuvendit**

*Nebojsa Arsic*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e parë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 31.01.2018, duke filluar në orën 11.00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Bajrush Ymeri, anëtarët Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic, Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Xhevat Mehmeti, Xhejlane Behluli, Abdyl Gashi, Ramush Mehmeti, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, zyrtar komunal, përfaqësuesi i OSBE-së, Edmond Hyseni si dhe një numër i qytetarëve.

Kryesuesi Nebojsa Arsic pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit dhe mund të fillojmë me këtë:

**R e n d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e jashtëzakonshme e Kuvendit;
2. Plani i mbajtjes së mbledhjeve;
3. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Formimi i Komitetit për Komunitete;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmië a pajtohen më këtë rend ditë apo keni ndonjë propozim?

Drejtori i Financav zt. Sercan Todorovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: dua që ti lus antarët e Kuvendit që të jetë edhe një pikë shtesë Raporti Financiar për periudhën tre mujorsh të tetor-dhjetor 2017, une ju kërkoj falje që nuk kam arritur ta sjell me kohë materialin mirpo ka qenë e pamundur të kyçemi në sistem për ti siguruar këto të dhëna, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti Antarë nga partia e AKR-së pasi përshëndeti të pranishmit tha: unë mendoj që njëher duhet të kemi raportin për tremujorshin e fundit mandej të bisedojm, nese eshte urgjent jam për më përkrah mirëpo njëher duhet të analizohet, rishikohet dhe pastaj të aprovohet, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: ne do te ju shperndajm raportin tash, por per shkak që skemi mundur të kyçemi në sistem nuk kemi mundur më herët ti sigurojm këto të dhëna pranadaj ju kisha lutur që ta perkrahi këtë pikë, ju faleminderit.

Pasi nuk pati diskutime tjera rreth kësaj pike u votua me 14 vota për dhe 1 apstetim që të futet si pikë shtesë në rendë dite raporti financiar i të hyrave dhe të dalurave për periudhën tetor-dhjetor 2017.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a kanë edhe ndonjë propozim për rendë dite?

Selatin Beqiri zyrtar në Drejtorin e Katastrit dhe Urbanizimit pasi përshëndeti të pranishmit tha: kërkoj që Kuvendi sot të formoj një komision prej 3 antarëve të Kuvendit dhe 2 të Komunës, për shkak se Komuna

## Procesverbali i Kuvendit

në vitet e mëhershme u ka marrë prona pronarëve ku ne sot egzistojm si Komunë dhe ju ka dhënë në një vend tjetër por nuk janë të caktuara pikat gjeodezike në terren dhe për tu caktuar pikat se kuj ku i takon ajo pjesë duhet të caktohet një komision i formuar nga Kuvendi për arsye se Kuvendi ja ka dhënë token pronarit, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që nuk pati diskutime tjera u votua njëzëri nga gjithë antarët e Kuvendit që të futet edhe kjo pikë në rendë ditë.

Pasi nuk pati propozime tjera rendi i ditës u aprovua unanimishtë nga anëtarët e Kuvendit.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua unanimishtë nga anëtarët e Kuvendit.

**Pika e dytë:** Plani i mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi tha: Sa i përket kësaj pike me material ju kemi dërguar edhe orarin e mbledhjeve të Kuvendit që do të mbahen gjatë këtij viti, Kuvendi është i obliguar që për një vit së paku ti mbaj 12 mbledhje, ky është vetëm një propozim dhe ne jemi munduar që mbledhjet mos të jenë ditëve të premete dhe në ndonjë ditë festë nëse dikush nuk pajtohet me këtë propozim mundë ta ndryshojmë, mundë të ketë ndonjë ndryshim në orar gjatë këtij viti për shkak të angazhimeve që do t'i kemi, mirëpo ne do të mundohemi t'i përmbahemi maksimalishtë këtij orari.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: mendoj që është një gabim i vogël në këtë plan të punës, sepse muaji gusht është muaji i pushimeve, ne mundë të mbajm ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme që ta plotësojm dhe një vërejtje për kryesuesin pasi që neni 43 i Ligjit për Vetqeverisje Lokale, pika 3 thotë se seanca e kuvendit thirret shtatë ditë pune para mbajtjes së Kuvendit dhe me ftesë pune ju keni thirr sot është e shtata ditë, realisht seanca e Kuvendit mbahet në ditën e tetë, prandaj keni kujdes në të ardhmen që mos të bëhen shkelje të ligjit, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: në vitin e kaluar janë mbajtur dy mbledhje në shtator, nese eshte problem për pushim mundë të ndryshojm ose ta mbajm ne fund të shtatorit.

Ramush Mehmeti tha: une nuk jam kundër që ta mbahen 12 senaca për një vit, mirpo pa asnjë muaj pushim kjo është diqka apsurde, pasi që edhe Kuvendi i Kosoves muajin gusht e ka pushim, nese mbledhja e Kuvendit mbahet ne fundë të muajit, mbledhja e KPF-së duhet mbajtur 10 ditë para kështu që komplet muaji po përfshihet në punë, megjithatë unë po pajtohna që të mbahet një seanc e jashtëzakonshme pasi që këto senaca nuk janë obligative, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: te mbahen dy mbledhje ne muajin shtator dhe kjo mbledhje e gushtit te mbahet me 6 shtator e enjte.

Pasi nuk pati diskutime tjera rreth kësaj pike unanimishtë u aprovua nga anëtarët e Kuvendit orari i mbledhjeve për vitin 2018 me nje ndryshim që mbledhja e muajit gusht të mbahet me 6 shtator.

**Pika e tretë:** Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi tha: Ne në këtë mbledhje do ta formojmë Komitetin për Politikë dhe Financa, siç e dini Kuvendi i ka dy Komitete obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Komiteti për Komunitete. Në baz të nenit 52 te Ligjit për Vetqeverisje Lokale Komiteti për Politikë dhe Financa duhet ti ketë 7 antaë dhe do të mirren të gjitha partit.

Antërët nuk do të propozohen por vetëm do të përgjidhen në bazë të marrëveshjes. Antarët e KPF-se do të jenë 4 nga komiteti serb dhe 3 nga komiteti shqiptarë.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: unë shumë po pajtohna me propozimin, 3 antarë të Kuvendit duhet të përfaqsohen ne KPF, gjithashtu e kemi edhe Komitetin për Komunitete që do të përfaqsohen dy nga komiteti shqiptarë, pasi që ne jemi 6 antarë në Kuvend unë propozoj që 3 antarë të Kuvendit të të

përfaqësohen në KPF nga partia LDK, AKR dhe VV ndërsa në Komitetin për Komunitete të përfaqësohet partia e LDK dhe PDK në këtë mënyrë që të përfaqësohen të gjithë, ju faleminderit.

Zv.kryesuesi Bajrush Ymeri pasi përshendeti të pranishmit tha: ne kemi përvojë në gjedhjen e këtyre Komiteteve Obligative të Kuvendit të Komunës, në KPF nuk ka mundësi që të përfaqësohen të gjitha partit politike për arsye të numrit të kufizuar, ne e kemi me statut se në ligj thuhet Komunitat që i kanë 15 antarë të Kuvendit Komunal numri maksimal i antarëve të KPF-së duhet të jetë 5 por ne me statut e kemi të rregulluar 7 dhe këtë do ta përkrahmi por përfaqësimi në këtë komitet nuk duhet të jetë i njëjtë sikur një subjekt që ka 3 ulse në Kuvend si një subjekt me 1 ulse, asnjë mundësi ska që të gjitha partit të përfaqësohen në këtë komitet prandaj koform përqindjes që e kemi marrë në zgjedhje në KPF nga 3 antarë që do të jenë nga komiteti shqipëtarë LDK-ës i takojnë 2 ndërsa subjekteve tjera 1, tani a do të bëni ju një marrëveshje që të përfaqësoheni nga subjekti politik që ka marrë më së shumti vota apo të keni një përfaqësim me rotacion është qështje e e juaj por ne do ti kemi dy antarë në KPF dhe propozoj Xhevat Mehmeti dhe Xhejlane Behluli, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: unë mendoj që për të mirë të gjithë subjekteve politike që të përfaqësohen të gjithë antarët e Kuvendit në këto komitete dhe në bazë të nenit 52 të Komitetit për Politik dhe Financa ku nuk ceket përqindja e partis politike p.sh KK në Komunën e Gjilan sa antarë i ka të përfaqësuar në KPF vetëm më qëllim të përfshirjes së gjithë partive politike, rasti tjetër në Komunën e Vushtrris përbëhet prej 8 antarëve dhe kryesuesi, Prishtina është 10 dhe Gjilani 10 vetëm për këto qëllime, nese përzgjedhja bëhet në këtë formë vërehet që nuk është kjo marrëveshje mirëkuptimi, sepse në ligj nuk ceket në bazë të përqindjes dhe besoj se kjo është forma më e mirë pasi që po përfaqësohen të gjithë antarët e Kuvendit nga komuniteti shqipëtar në KPF dhe në Komitetin për Komunitete, ju faleminderit.

Zv.Kryesuesi tha: unë nuk e kam pranë rregulloren, por në rregullore shkruan ashtu si e thash unë, në rradhë të parë duhet me shiku përqindjen që e kanë fituar subjektet politike dhe në bazë të përqindjeve dhe ulsev që i kanë ju takon përfaqësimi në komitete, e kemi rastin e Komunës së Vitisë PDK dhe VV kanë bërë marrëveshje me rotacion njëri subjekt politik 2 vite dhe tjetri 2 vite. Kështu ka qenë edhe në mandatin e kaluar dhe unë nuk tërhiqem nga ajo që e thash, LDK-së në bazë të përqindjes që i ka 3 ulse në Kuvend i takojnë 2 antarë në KPF, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: kryesuesi shumë mirë e tha që të përfaqësohen gjitha partit politike, në ligj nuk ceket përqindja dhe nese nuk respektohet ligji në të tri paratit politike nuk do të jem pjesë e asnjë Komiteti, ju faleminderit.

Zv.Kryesuesi tha: edhe njëherë të them dhe nuk do të flas për këtë pikë, nese nuk don me kuptu është qështje tjetër, por KPF përfaqësohet nga antarët e Kuvendit në bazë të votave që kanë marrë në këtë rast ne i kemi 3 ulse në Kuvend, prandaj nuk është e drejtë që të jetë përfaqësimi i njëjtë si një subjekt politik që ka marrë mbi 900 vota si një subjekt me mbi 200 vota dhe përbërja e KPF-ës është e qartë pra do të jenë 7 antarë, 4 nga komuniteti serb si tha kryesuesi dhe 3 nga komuniteti shqiptarë ku 2 përfaqësues do të këtë LDK dhe unë i propozova emrat dhe 1 nga subjektet tjera politike se si bëni ju marrëveshje është qështje e juaj.

Ramush Mehmeti tha: unë nuk po kërkoj asgjë, nuk e kontestova përqindjen e votave vetëm po thirrem në bazë të ligjit, atë ligj e ka aprovu Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Pushtetit Lokal dhe atë ligj duhet ta zbatojmë, nese shkruan në ligj në bazë të përqindjes së votave unë plotësisht pajtohem.

Abdyl Gashi antar nga Levizja VV pasi përshendeti të pranishmit tha: sa i përket përfaqësimit besoj që edhe zt.Bajrush Ymeri nuk e ka ligjin përpara, le ta cekë nenin cili e saktson përcaktimin e përfaqësuesve në KPF atëherë bindemi, përderisa folë kështu dhe tregon ligjet që nuk janë të caktuar në Ligjin për Vetqeverisje Lokale atëherë besoj që je duke përfaqësuar vetëm subjektin tond politik dhe subjekti politik nuk nxjerr ligje por nxjerr përfaqësues të asambles, duhet ti respektoni ligjet në përpikëri të Kuvendit Komunal, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: neni 52 i KPF dhe 51 pika 1 thotë se Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteve politike në

Kuvendin e Komunës dhe pasi ne kemi më shumë parti në Kuvend dhe numri në KPF është i Kufizuar duhet të arrihet një marrëveshje që përfaqësimi të jetë i drejt.

Ramush Mehmeti tha: ne plotësishtë po pajtohemi, nuk po kërkojm që të jemi të gjitha partit politike në KPF duke e shikuar situaten në Komunën tonë, shumë qartë e thash që në KPF të përfaqësohet 1 i LDK-së, 1 i AKR-së dhe 1 i VV, ndërsa në komitetin per komunitete merr pjesë 1 i LDK-së dhe 1 i PDK për arsye që po arrijm që të gjithë të jemi të përfshirë në këto komitete.

Zv.Kryesuesi tha: kështu ka qenë gjithmonë edhe kështu duhet të vazhdoj zt.Ramush nese don me kuptu, nese sdon është qështje tjtër, ne jemi 3 ulse ne KK dhe i kemi mbi 900 vota dhe nuk mundë të jemi të barabart me ty me mbi 200 vota, të gjithë subjektet politike në KPF nuk mundë të përfaqësohen sepse 3 janë nga komuniteti serb dhe 4 nga komuniteti shqiptarë gjithsej 7 dhe sipas teje secili duhet të këtë nga një antarë ne këtë komitet barabarë sikur aj që ka përqindje të votav më të madhe si aj që ka përqindje më të vogël nuk mund të trajtohen njëjtë, edhe në mandatin e kaluar dihet se si ka qenë përbërja e KPF.

Zt.Kryesues nese i ke 4 emra nga komuniteti serb, unë 2 i propozova, merre edhe një propozim dhe hudhe në votim.

Ramush Mehmeti tha: une si antarë i Kuvendit propozova që përfaqësimi të bëhet në këtë formë të partive politike, nëse jeni për kompromis dhe për ta bërë një zgjedhje më të mirë që proceset të shkojnë përpara mendoj se kjo është zgjedhja më e mirë.

Xhevat Mehmeti antar nga partia e LDK-së pasi përshendeti të pranishmit tha: e kam një vërejtje për Kryesuesin për munges të ujit në sall, dhe e dyta për ta zgjidhur këtë ngërç politik propozoj që në KPF të përfaqësohet edhe Ramush Mehmeti.

Kryesuesi tha: sa i përket të dy komuniteteve si shqiptarë ashtu edhe serb duhet që të arrihet një marrëveshje që të ketë përfaqësues në mënyrë të drejt, prandaj ju kisha lut që të propozoni edhe një antarë nga komuniteti shqiptarë.

Abdyl Gashi tha: dëshira dhe ligji janë të ndryshme prandaj ju mbetet juve kryesues se ca e zgjedh deshiren me ja plotësu njërit apo ta respektoni ligjin.

Zv.Kryesuesi tha: zt.kryesues ju duhet të keni rregulloren për themelimin e këtyre komiteteve, prandaj ne e dham propozimin ju i keni katër emra, neve na takon ti kemi dy përfaqësues sepse e kemi përqindjen më të madhe të votave, nuk e di pse po këmbngulni në diqka që sju takon, juve ju takon të keni vetëm një përfaqësues nese doni propozoni një antarë, unë sikur ta kisha pasur një ulse në Kuvend sikur ti nuk kisha këmbngul kështu, juve ju takon me rotacion sikur çdo Komunë, nuk ka mundësi që të përfaqësohen të gjitha subjektet politike ne KPF, nuk ka këtu marrëveshje, këtu ka vota, ulse sa i kemi marrë.

Ramush Mehmeti tha: nese thuhet ne bazë të votav që i kem atëher ti i ke 3 ulse në Kuvend ne i kem 3 jemi barabarë, megjithat unë po bazohna në ligj këtu po shkrun shumë qartë përfaqësimi i etnive politike pasi që nuk po mundë të marrim pjes të gjitha partit politike, se paku të marrin pjesë partit më të mdhaja, unë kam thën edhe në mbledhjen e parë se ne mundë të debatojm gjatë por e rëndësishmë është të aprovojm vendime unanime, nese votohet propozimi i juaj ne nuk do të marrim pjesë në asnje komitet.

Kryesuesi tha: po kthehem te ajo që thash më herët, nuk duhet patjetër të të përfshihen gjitha subjektet politike në KPF pasi që aty numri është i kufizuar dhe ne kemi më shumë subjekte politike kështu që të arrihet një marrëveshje.

Ramush Mehmeti tha: ne po pajtohemi, prandaj partia më me pak vota është në komitetin për komunitete dhe nuk po them që patjetër të marrim pjesë të gjithë por të arrijm një kompromis deri dikund se ktu shumë mirë po shkruan që reflekton përfaqësimin e etnive politike e spo thot përqindjen politike.

Xhevat Mehmeti tha: zt.Kryesues nese bon një ide duke e ditur përvojën tuaj pasi që është mbledhja e parë por kisha kërku që mos ta zgjatni tepër dhe të shkojm me votim.

Kryesuesi tha: kisha kërku edhe një propozim për antarë të KPF.

Zv.Kryesuesi tha: vërtet jemi bërë të tepërt rreth kësaj pike, unë tkisha lut me procedu në votim, i kë katër antarë nga komuniteti serb dy anëtarë unë i propozova dhe kështu do të jetë, lexone çdo rregullore

çdo ligj, nese dikush ka vërejtje duhet të ankohet ne MAPL dhe Ministria e kthen përgjigjen dhe pastaj vepron sipas vendimit të Ministrisë, unë jam i bindur që kështu duhet të jetë.

Ramush Mehmeti tha: unë i pari dhash propozimin që në KPF të përfaqësohen 1 i LDK-së, 1 i AKR-së dhe 1 i VV prandaj prej grupit ton propozojm që në KPF të jetë përfaqësuesi i AKR-së dhe i VV, unë po pajtohem plotësisht nese ligji thot në bazë të përqindjes por këtu po thotë përfaqësimi i partive politike aq sa është e mundshme, prandaj ne si 5 antarë të Kuvendit po arrijmë që të gjithë të përfaqësohemi ne komitete, mendoj që ky është kompromisi më i mirë.

Kryesuesi tha: Propozoj që të kemi 10 minuta pauzë deri sa të konsultohemi me subjektet politike për Komitetin për Politikë dhe Financa.

Pasë pauzës Kryesuesi tha: pasi kemi lexuar nenin 52 e kemi edhe udhëzimin administrativ, neni 5 i udhëzimit administrativ thotë se KPF përbëhet nga përfaqësuesit e partive politike dhe paragrafi 2 ne këtë komitete nese e kanë të pamundur të marrin pjesë të gjitha partit politike siç është rasti të ne atëher do të marrin pjesë ato parti që përfaqësohen më shumë ulse në Kuvend.

Ramush Mehmeti tha: shume mirë u sqaru në ligj qe në bazë të përqindjes të përfaqësohen më shumë subjekte politike propozimi im ishte i pari dhe ishte kështu shkojm me votim dhe shohmi se a do të aprovoht apo jo, propozimi i dyt është i kuart ky po fol ne emër të LDK-ës, ju kisha lut që të shkohet me votim me propozim timin.

Zv.Kryesuesi tha: pasi që tash e kemi udhëzimin administrativ për themelimin e KPF-së, unë mendoj që çdo gjë është e kuptueshme, këtu askush nuk ka të drejt të hudh vendime në votim të jashtëligjshme, kërkesa e juaj është e jashtëligjshme, e ligjshme është kjo që lexoj Kryesuesi, prandaj nuk kemi pse të diskutojm më tepër.

Predrag Stojkovic pasi përshendeti të pranishmit tha: kam menduar fare te mos kyçem në këtë temë por pas shumë diskutimesh disa vërejtje, kryesuesin e kisha lut që të vepron në bazë të rregullores së punës të Kuvendit, e dyta nese e përdormi si zgjedhje këtë rregullore atëher vetëm 5 anatrë duhet të jenë në KPF miëpo unë e kam një propozim pasi që ka kaq shumë diskutime të tërhiqet kjo pikë dhe të konsultohemi me Ministrinë për këtë qëshhtë, ju faleminderit.

Zv.Kryesuesi tha: i nderuar antarë i kuvendit faleminderit shumë për diskutimin por vërtet ne e dimë që kem të drejt edhe me ligj edhe me udhëzim administrativ, këtu dueht të ipen propozimet dhe duhet të votohen, subjektet tjera lë të propozojn me rotacion sikur kanë vepruar gjitha Komunitat tjera.

Kryesuesi tha: po i hudhi në votim të dy propozimet. Për propozimin e zt. Bajrush Ymeri ishin 11 vota për, 3 kunder (Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi dhe Selatin Nuhiu) dhe 1 apstenim.

Kryesuesi tha: ju kisha lut paritive politike AKR,VV,PDK të bëjnë një propozim edhe për një antarë.

Ramush Mehmeti tha: pasi që ju me shumic votash e shkelet ligjin ne si grup politik nuk do të marrim pjesë në asnjë komitet.

Selatin Nuhiu antarë nga subjekti politik PDK pasi përshendeti të pranishmit tha: unë mendoj se është duke u shkelur rregullorja e Kuvendit e përseriti Kryesuesi në mandatin e kaluar LDK i ka pasur katër antarë ndërsa PDK një, në të gjitha komitetet kanë qenë të përfaësuar antarët e LDK dhe kjo nuk është e drejt.

Kryesuesi tha: pasi që nuk po pajtoheni ta tërhekim këtë pikë nga rendi i ditës të konsultohemi me Ministrinë dhe pastaj vendosim në mbledhjen e rradhës të vendosum.

Zv.Kryesuesi tha: zt.kryesues tu kisha lut pasi që i kë 6 emra për KPF dhe komiteti mund të formohet dhe të funksionoj, një vend mbetet i lirë dhe kur do subjektet politike mundë të propozojn, KPF mundë të funksionoj edhe me 6 antarë, ne nuk po bëjmë shkelje ligjore dhe nese dikush konsideron se ne kemi bërë shkelje ligjore me këtë vendim mundë ti drejtoheni Ministrisë me shkres, me procesverbal dhe Ministria na përgjigjet se a është bërë shkelje apo nuk është bërë.

Ramush Mehmeti tha: zt.Kryesuesi unë pajtohem me propozimin e tuaj dhe të Kryesuesit të mëhershëm, nese LDK i ka 3 ulëse le të përfaqësohen të tret në KPF sepse ka vota, mirëpo me ligj nuk ceket që nese një

parti sa e ka përqindjen aq anatrë të përfaqësohen, nese aprovohet ky vendim në si grup nuk do të jemi pjesë e asnjë komiteti.

Zv.Kryesuesi tha: zt.kryesues edhe njëher po te luti vazhdojm me mbledhjen hudhe në votim pasi që i ke 6 emra dhe 1 mbetet i zbrazët nese pendohen mundë të propozojn në mbledhjet e ardhshme, në fillim të kësaj seance hasim në kësi probleme duke e ditur që nuk i takon as me rregullore as me ligj.

Xhevat Mehmeti tha: zt.Kryesues tu kisha lut shumë që më shumë se dy herë mos me ja dhan fjalën askujt.

Kryesuesi tha: i kisha lut partit politike AKR, VV dhe PDK të propozojn edhe një antarë në mënyrë që të plotësohet numri në KPF.

Pasi që nuk ka propozime e hudhi në votim me 6 antarë.

Pasë diskutimeve që janë bërë me 11 vota për 1 kundër (Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu) dhe 1 apstenim të anëtarëve të Kuvendit u prua ky:

#### V E N D I M

Formohet Komitetit për Politikë dhe Financa me këtë përbërje:

1. Nebojsa Arsic - LS
2. Milica Jovanovic-GI
3. Predrag Stojkovic - LS
4. Mirjana Simijonovic - LS
5. Xhejlane Behluli- LDK
6. Xhevat Mehmeti - LDK

**Pika e katërt:** Formimi i Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi tha: Në bazë të Ligjit obligative është edhe Komiteti për Komunitete neni 51 dhe 53 si dhe në bazë të nenit 40 dhe 42 të Statutit të Komunës, po ashtu edhe ky Komitet duhet t'i ketë 7 anëtar shumica duhet të jenë nga Kuvendi dhe pakica nga shoqëria civile. Në këtë mbledhje duhet ti zgjedhim 2 antarë nga komuniteti shqiptarë dhe 2 nga komuniteti serb.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a kanë ndonjë propozim rreth këtij Komiteti?

Predrag Stojkovic tha: antarët e KPF nuk mund të jenë në komitetin për komunitete.

Abdyl Gashi tha: ne si grup nuk do të marrim pjesë në këtë komitete.

Xhevat Mehmeti tha: unë mendoj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet pasi që ne nuk i kemi emrat nga shoqëria civile.

Kryesuesi tha: Sa i përket zgjedhjes nga shoqëria civile, është një procedurë e veçantë, ne do t'i zgjedhim vetëm anëtarët nga Kuvendi ndërsa për mbledhjen e radhës do t'o zgjedhim edhe nga shoqëria civile.

Xhevat Mehmeti tha: unë propozoj Bajrush Ymerin.

Ramush Mehmeti tha: ju thash edhe në fillim po ju them edhe tash që në fillim të punës keni bërë shkelje ligjore prandaj ne si grup nuk marrim pjesë në asnjë komitet dhe nese e shtyni këtë pikë atëher ju po i shtyni pikat se si po ju përshtatet juve.

Zv.Kryesuesi tha: edhe njëher e lus zt.Ramushin qe mos të thirret në shkelje të rregullores, harrum me lexu edhe diqka shumë të rëndësishme në këtë udhëzim administrativ neni 6 përfaqësimi në KPF numri i anëtarëve që përfaqësohen duhet të jet proporcionalisht me fuqin votuese te subjektev politike.

Predrag Stojkovic tha: ne kështu kemi punuar që në mbledhjen e parë në këtë mbledhje duhet të zgjidhen vetëm antarët nga Kuvendi dhe në mbledhjen e ardhshme të zgjidhen antarët nga shoqëria civile.

Kryesuesi tha: propozoj që të tërhiqet kjo pikë për shkak të mosëmarrveshjeve.

Ramush Mehmeti tha: shumë mire zt.Kryesues piken e Kpf nuk e terheqet dhe bëtë shkelje ligjore, ndërsa këtë pikë po e tërhiqni.

**Pika e pestë:** Raporti financiar i të hyrave dhe të dalurave për periudhen tetor-dhetor 2017, janar 2018;

Kryesuesi tha: ne fillim i futum në rend dite edhe dy pika tjera e para është raporti financiar i të hyrave dhe të dalurave për periudhen tetor-dhetor 2017, janar 2018, ja dha fjalën propozuesit të kësaj pike.

Drejtori i Financave Sercan Todorovic tha: kërkoj falje edhe njëher që nuk kemi mundur me kohë tju dergojm materialin por besoj që pat koh ta analizoni, do të mundohem të jem i shkurtë pasi që të gjithë e keni raportin para vetes, të hyrat vetanake në total janë 54,839.03€, të hyrat e tatimit në pronë janë 15,355.06€, nga regjistrimi i automjeteve janë 4,490.00€, tax komunale për leje ndërtimi janë 17,153.87€ etj., Të planifikuara për paga dhe medite gjatë këtj tre mujori kanë qenë 441,544.00€ ndërsa janë shpenzuar 435,726.13€, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar në total 50,236.13€, për shpenzime komunale janë shpenzuar 25,402.01€, për subvencione janë shpenzuar 4,141.00€ dhe për investime kapitale janë shpenzuar 162,191.05€ në material i keni të ndarë për secilin sektor, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin rreth kësaj pike.

Abdyl Gashi tha: besoj që nuk është një praktik e mirë që të bihet një raport ne momentin e fundit ne seanc për arsye se duhet të kemi kohë që secili përfaqësues i qytetarëve ta shqyrtoj dhe ta analizojm mirë që të dimë se për çfarë raporti po votojm, ne seancen e parë po tregohet që nuk ka seriozitet ky Kuvend të punoj dhe bashkëpunoj me asambleistat në mënyrë korrekte, unë do të jem kundër këtij raporti financiar pasi që nuk patem kohë ta analizojm, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: e kemi futur si pikë shtesë pasi që nuk kanë pasur mundësi që ta sjellin materialin me kohë për arsye të mosfunksionimit të sistemit, dhe këtë raport duhet të aprovohet ne kuvend dhe jo te votohet nga qytetarët, ne mundë të bëjmë edhe një pauz dhe ju të analizoni.

Xhevat Mehmeti tha: e përgzoj Drejtorin për raportin që e ka bërë, por kërkoj që herën tjetër të na sjellni informata se në cilën pjesë është paguar tatimi më shumë, dhe një vërejtje për zyren e barazis gjinore asni shërbim nuk është kryer, si funksionon ajo?

Dobrivoje Djordjovic pasi përshendeti të pranishmit tha: kjo për mua është diqka e re, siç e tha edhe kolegu më herët duhet çdo Drejtor të sjell informata më shumë, nese është urgjente do të votojm por duhet të dimë se çka do të votohet, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: ne mbledhjet e ardhshme do të jet raporti vjetor dhe do ti keni te gjitha të bashkangjitura.

Zv.Kryesuesi tha: ne tu kuptum ty Drejtor dhe e ke then drejt sepse e di që e ke pasur të pamundur të kyçesh në sistem dhe erdh pak me urgjenc por mos te jet praktik për herat tjera, pasi që ne e votum që të hyn si pikë shtes në rend ditë besoj që u pajtum të gjithë që të aprovohet ky raport, sa i përket qështjes tjetër Abdyl tu kisha lut pasi që ne jemi këtu që 18 vite dhe ande askush nuk na ka akuzuar për shkelje të ligjit, këtu i kemi edhe përfaqësuesit e OSBE-së që e monitorojn Kuvendit, është edhe Ministra që e percjellin në mënyr të drejtpërdrejt, unë gjithmon kërkoj diqka që është në harmoni me ligjin dhe jam i bindur që kjo është e drejt, nese konsideron që është shkelur ligji ke të drejt të ju drejtohesh në Ministri.

Abdyl Gashi tha: po filloj me kryesuesin pasi që tha se qytetarët nuk votojn, ndërsa unë e përfaqësoj një pjesë qytetare dhe do të mundohet ti përfaqësoj edhe ata që nuk i kanë përfaqësuesit e denjë dhe nuk i mbrojn interesat e tyre dhe kur kemi të bejmë me raporte finaciare besoj që të financat është puna ma e ndishme që ka Komuna, sa i përket Bajrush Ymerit unë edhe sot po i them që ne do ti ndjekim të gjitha rrugët ligjor që e monitorojn Kuvendit, besoj që nuk ka të pagabushëm mundë të shkelet ligji por janë organet kompetente për të na sugjeruar për veprimet e bëra.

Pasi nuk pat diskutime tjera me 10 vota për, 3 kunder (Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu), 1 apstetim dhe 1 antarë mungojë u votua kjo pikë dhe u pru ky:

#### V E N D I M

**APROVOHET** raporti financiar i Komunës së Novobërdës për tremujorin e katërt të vitit 2017.

**Pika e gjashtë:** Formimin i komisionit për evidentim të disa pronave;

Kryesuesi tha: e kemi shtu edhe një pikë shtesë nga Drejtorja e Katastrit, dmth duhet të formohet një komision prej 3 antarëve të Kuvendit dhe 2 të Komunës, për shkak se Komuna në vitet e mëhershme u ka marrë prona pronarë ku ne sot egzistojm si Komunë dhe ju ka dhën në një vend tjetër por nuk janë të caktuara pikat gjeodezike në terren, a keni ndonjë propozim prej Kuvendit për këtë komision?.

## Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesi e hapi diskutimin rreth kësaj pike.

Ramush Mehmeti tha: si te formohet komisioni kur propozuesi nuk është prezent në sall.

Selatin Nuhiu tha: nese ka mundësi të shikohet materiali se sa ari janë apo për çfarë bëhet fjal.

Dobrivoje Djordjovic tha: nuk e di se qfare praktike ka qenë më herët, por pasi që propozuesi nuk është këtu nuk e di se si të veprojm.

Zv.Kryesuesi tha: propozuesi nuk është në sall sepse mendoj që e sqaroj mjaftushëm, kjo ka të bejë me sa kuptova që kjo pjesë ku është Komuna ju është marr një pronari privat një pjesë dhe dhe ju është ndrru me një parcel tjetër dhe komisioni duhet të formohet për mu caktu pikat.

Abdyl Gashi tha: një sygjerrim që kur të ketë propozime të pikav shtesë një flet me disa rreshta që të kemi më të lehtë se çfar komisioni ne mënyr që të pergjedhen personat adekuat.

Kryesuesi tha: pasi qe propozuesi nuk është në sall e terheqim këtë pikë nga rendi i ditës.

**Pika e shtatë:** Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Ramush Mehmeti tha: dua të diskutoj për një qështje ku Bajrush Ymeri tha nese ka shkelje te ligjit tregona dhe unë e kisha pyet me 14 dhjetor je antarë i Kuvendit ndersa ende mban zyren e nënkryetarit të Komunës, Ligji për Vetqeverisje Lokale thotë se nenkryetari i Komunës zgjidhet në një mandat sikur Kryetari, ju përveq qe jeni duke e keqperdorur poziten komunale ju me 12 janar e keni dhenë betimine anatrëit të Kuvendit, tash je zv.kryesues ndërsa në list të pagave të janarit e ke marr pagen si nenkryetar dhe me këtë keni bërë shkelje ligjore.

Dobrivoje Djordjovic tha: pasi që në Komunën tonë nuk ka stadium kisha propozu qe Komuna të merrë një inicativ për ndertimin e stadiumit pasi qe Ministria ka shpreh deshiren te investoj, qështja tjetër kisha kërkua që të kete inspektor për mbeturina pasi që në shum fshatra jan të grombulluara dhe askush nuk i denon dhe nuk merret me këto qështje.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe e mbylli mbledhjen në orën 13:00

**Valmire Mustafa**

Procesmbajtëse



**Nebojsa Arsic**

Kryesues i Kuvendit





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

# **RREGULLORE E PUNËS SË KUVENDIT NOVOBËRDË**

**PRILL 2013**

# Rregullore e Punës së Kuvendit Komunal të Novobërdës

Në pajtim me paragrafët 2 (b) dhe 4 të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), Kuvendi Komunal i Komunës së Novobërdës, de neni 27 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Novobërdës, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2013

## Rregullore Pune

### Neni 1

1.1 Rregullorja e Punës përcakton punët dhe mënyrat e funksionimit të Kuvendit Komunal të Komunës dhe të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit komunal.

1.2 Kjo Rregullore Pune zbatohet po ashtu edhe për komitetet e përhershme të kuvendit komunal.

### Neni 2

Në këtë Rregullore Pune, termat e përdorur do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“**Komuna**” nënkupton Komunën e Novobërdës;

“**Sekretariati i kuvendit**” nënkupton shërbimin relevant që i ofron ndihmë kuvendit komunal dhe organeve të tij;

“**Çështje urgjente**” nënkupton çështje të lidhur me situatë të vërtetë urgjente, për të cilën kuvendi duhet të vendosë dhe e cila nuk mund të paraqitet në kuvend gjatë një periudhe të arsyeshme kohore;

“**Fjalë apo veprime të pamatura**” nënkupton fjalë të folura apo shkruara që përdoren në Kuvendin Komunal apo Komitetet e tij dhe të cilat:

- a) Janë fyese ose kërcënuese;
- b) Janë sulme apo ofendime personale;
- c) Janë në gjuhë jo-parlamentare;
- d) Nxisin dhunë;
- e) Nxisin dhunë gjinore;
- f) Janë akuza të drejtpërdrejta kundër ndonjë anëtari të kuvendit komunal ose drejtori të ndonjë Drejtorati.

“**Grup i kuvendit**” nënkupton grup prej tre ose më shumë anëtarëve të një partie, koalicioni ose nisme qytetare, të cilët janë anëtarë të kuvendit komunal dhe të cilët e kanë informuar kryesuesin e kuvendit për qëllimin e tyre që të veprojnë si grup i kuvendit;

“**Javë pune**” nënkupton javën e punës gjatë së cilës kuvendi mban mbledhje të rregullta, përveç javës kur kuvendi mbledhet gjatë ditëve jo punuese për të diskutuar çështje urgjente;

“**Ditë pune**” nënkupton ditën e javës nga e hëna deri të premten, duke i përfshirë të dyja dhe përjashtuar festat publike, gjatë javës në të cilën zakonisht mbledhet kuvendi.

### Neni 3

#### Mbledhja Përruese e Kuvendit Komunal

3.1 Mbledhja përruese e kuvendit komunal mbahet jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

3.2 Mbledhja përruese e kuvendit komunal thirret nga Kryetari i zgjedhur i komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

3.3 Nëse Kryetari nuk e thërret mbledhjen siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni, apo nuk është zgjedhur ende, atëherë anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit e thërret mbledhjen përruese të

kuvendit komunal brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas dështimit të Kryetarit për ta thirrë mbledhjen përruruese.

3.4 Nëse anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit nuk e thërret mbledhjen, siç parashihet në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja përruruese e kuvendit komunal mund të thirret me nismën e shumicës së anëtarëve të zgjedhur të kuvendit komunal.

3.5 Mbledhjet e kuvendit komunal të mbajtura para zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit kryesohen nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit.

3.6 Kryesuesi i mbledhjes kërkon nga Kryetari i komunës dhe anëtarët e tjerë të kuvendit që ta nënshkruajnë deklaratën ose ta bëjnë betimin solemn.

3.7 Kryetari i komunës bën betimin solemn si më poshtë: "Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej detyrat e mia dhe ushroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Novobërdës me nder, besnikëri, paanësi, ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, ashtu që të sigurohen kushtet për jetë paqësore dhe prosperuese për të gjithë qytetarët". Teksti i betimit të Kryetarit lexohet nga kryesuesi ndërsa Kryetari bën betimin me fjalën "Betohe". Pas kësaj, Kryetari nënshkruan betimin e tij.

3.8 Kryetari që nuk betohet ose që nuk e nënshkruan betimin brenda një muaji nga certifikimi i rezultateve zgjedhore pushon të jetë kryetar.

3.9 Të gjithë anëtarët e kuvendit komunal e nënshkruajnë deklaratën ose japin betimin e mëposhtëm: "Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej detyrat e mia dhe ushroj kompetencat e mia si anëtar i Kuvendit Komunal të Novobërdës me nder, besnikëri, paanësi, ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, ashtu që të sigurohen kushtet për jetë paqësore dhe prosperuese për të gjithë qytetarët". Teksti i betimit për anëtarët e kuvendit lexohet nga Kryesuesi, ndërsa anëtarët betohen me fjalën "Betohe". Pas kësaj, secili anëtar nënshkruan betimin e tij.

3.10 Çdo anëtar i kuvendit që nuk e bën betimin ose nuk nënshkruan atë brenda një muaji nga certifikimi i rezultateve zgjedhore pushon të jetë anëtar kuvendi.

3.11 Çdo anëtar që është i pranishëm në mbledhje duhet të nënshkruajë pranë emrit të tij/saj në listën e anëtarëve të kuvendit që bëjnë betimin, e cila përgatitet për këtë qëllim.

#### **Neni 4**

#### **Mbledhjet e rregullta të kuvendit komunal**

4.1 Kryesuesi i kuvendit thërret dhe kryeson mbledhjet e kuvendit komunal dhe, në mungesë të tij/saj, mbledhjet thirren dhe kryesohen nga Zëvendës-Kryesuesi për Bashkësi.

4.2 Në mungesë të kryesuesit të kuvendit dhe zëvendës-kryesuesit për bashkësi, mbledhja e kuvendit thirret nga një e treta (1/3) e anëtarëve dhe kryesohet nga anëtari më i vjetër i pranishëm në mbledhje i kuvendit.

4.3 Mbledhjet e kuvendit po ashtu mund të thirren edhe me kërkesën e ndonjë komiteti të kuvendit.

4.4 Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nga Kryesuesi ose zëvendësi i tij/saj, me kërkesë të një të tretës (1/3) së anëtarëve të kuvendit ose me kërkesë të kryetarit.

4.5 Përderisa nuk vendoset ndryshe, mbledhjet e kuvendit mbahen në sallën e kuvendit të komunës, në adresën: (duhet të paraqitet adresa e saktë sapo të identifikohet).

4.6 Mbledhjet e kuvendit komunal mbahen së paku dhjetë (10) herë brenda vitit kalendarik me mundësinë e mbajtjes së mbledhjeve varësisht nga kërkesa, pesë nga të cilat mbahen në gjashtë (6) muajt e parë.

4.7 Kuvendi dhe komitetet e tij mbajnë mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme në pajtim me Statutin, Rregulloren e Punës dhe rregulloret e komunës.

4.8 Kryesuesi ose, në mungesë të tij/saj, zëvendësi i tij/saj i informon anëtarët e kuvendit së paku shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së ndonjë mbledhjeje të rregullt ose tri (3) ditë pune pra ndonjë mbledhjeje të jashtëzakonshme.

4.9 Kuvendi komunal dhe komitetet, përmes shërbimit administrativ dhe teknik, i ftojnë anëtarët e tyre së paku tri (3) ditë pune para mbajtjes së ndonjë mbledhjeje të rregullt.

#### **Neni 5** **Përmbajtja e ftesës për mbledhje**

Ftesa për mbledhje që i dërgohet anëtarëve të kuvendit ose anëtarëve të komiteteve përmban pikat e mëposhtme:

- a) data e mbledhjes;
- b) koha e mbledhjes;
- c) vendi i mbledhjes;
- ç) rendi i ditës së mbledhjes;
- d) materialet e nevojshme për mbledhje në gjuhët që parashihen me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe Rregulloren e Komunës për Përdorimin e Gjuhëve;
- e) informatën nëse mbledhja do të jetë publike apo jo;
- f) informatën se kush e ka thirrur takimin; dhe
- hg) informata tjera të rëndësishme.

#### **Neni 6** **Publiciteti i mbledhjeve**

6.1 Të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal janë të hapura për publikun.

6.2 Kuvendi komunal mund të vendosë, para ose gjatë mbledhjes, me shumicë votash që të mbahet mbledhje e mbyllur plotësisht ose pjesërisht nëse publiciteti i çështjeve të diskutuara mund të:

- a) çojë në çrregullim ose dhunë publike;
- b) kërcënojë paraqitjen e informatave [dhe dokumenteve] paraqitja e të cilave kufizohet me ligj;
- c) kërcënojë dëmtimin e privatisisë ose paraqet informata të ndjeshme tregtare; ose
- ç) kërcënojë paraqitjen e informatave për procedurë gjyqësore të tashme ose të afërt.

6.3 Kur kuvendi vendos ta mbyllë mbledhjen ose një pjesë të saj, publiku njoftohet për atë vendim.

6.4 Kryetari, zëvendës-kryetari ose zyrtari i caktuar nga ai/ajo mund t'i ndjekë të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal.

#### **Neni 7** **Kuorumi dhe votimi**

7.1 Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit dhe komiteteve të tij është gjysma e anëtarëve të kuvendit ose komitetit.

7.2 Personi që kryeson mbledhjen verifikon kuorumin në fillim të çdo mbledhje dhe para se kuvendi të votojë. Kjo përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.

7.3 Në mungesë të kuorumit mbledhja shtyhet për datë të mëvonshme sipas Rregullores së Punës.

7.4 Votimi në kuvend bëhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) Thjeshtë me 'Po' ose 'Jo' duke e ngritur dorën;
- b) Votim të fshehtë kur shumica e anëtarëve të kuvendit kështu vendosin,
- c) Përmes votimit të regjistruar me nënshkrim të anëtarit pranë emrit të tij/saj.

7.5 Nëse kërkohet dhe miratohet votimi i regjistruar nga shumica e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, vota 'për', 'kundër' ose 'përmbajtje nga votimi', e secilit anëtar regjistrohet me emër dhe nënshkruhet nga anëtarët që marrin pjesë në mbledhje. Përmbajtjet llogariten vetëm me qëllim të formimit të kuorumit për mbajtjen e mbledhjeve dhe nuk llogariten ndryshe për rezultatet e votimit.

7.6 Në rast të numrit të barabartë të votave për dhe kundër ndonjë propozimi, vota e kryesuesit të mbledhjes do të jetë vendimtare.

Neni 8

### **Plani vjetor i punës i Kuvendit të Komunës**

1. Kuvendi i Komunës punon në bazë të Planit vjetor të punës.
2. Plani vjetor i punës së Kuvendit përmban:
  - 2.1 Objektivat e Kuvendit;
  - 2.2 Qëllimet e Kuvendit;
  - 2.3 Aktivitetet e planifikuara të Kuvendit;
  - 2.4 Aktivitetet e planifikuara të komiteteve obligative dhe funksionale;
  - 2.5 Aktivitetet e planifikuara të Grupit të Grave dhe grupeve tjera joformale të Kuvendit;
  - 2.6 Afatet për përmbushjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara;
  - 2.7 Koston financiare për implementimin e Planit të punës.
3. Nën udhëheqjen e Kryesuesit, Kuvendi i Komunës themelon grupin punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.
4. Grupi punues, në konsultim me Kryetarin e Komunës, drejtorët komunal, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik.
5. Para përfundimit të vitit aktual kalendarik, Kuvendi miraton Planin e punës të Kuvendit të Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik.
6. Në seancën e parë të vitit kalendarik, Kryesuesi i paraqet Kuvendit të Komunës raport mbi realizimin e Planit të punës për vitin paraprak kalendarik.
7. Plani i punës i Kuvendit të Komunës publikohet në faqen elektronike të Komunës në gjuhët zyrtare të Komunës.
8. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës organizon takime periodike me përfaqësues të OJQ-ve dhe mediave lokale me qëllim të vlerësimit dhe plotësimit të Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.

Neni xx

### **Mbikëqyrja e punës së Administratës së Komunës nga ana e Kuvendit të Komunës**

1. Kuvendi i Komunës çdo gjashtë (6) muaj shqyrton raportin e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike-financiare të Komunës.
2. Kuvendi i Komunës çdo tre (3) muaj shqyrton raportin tre mujor financiar për periudhën përkatëse.
3. Kryetari i Komunës ose Drejtori përgjegjës për implementimin e një rregulloreje komunale, është i obliguar që së paku dy herë në vit t'i paraqesë raport Kuvendit të Komunës mbi ecurinë e implementimit të rregullores përkatëse.
4. Afatet për shqyrtimin e dokumenteve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij Neni parashihen në Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.

## **Neni 8** **Rendi i ditës**

8.1 Rendi i ditës për mbledhjen e kuvendit propozohet nga kryesuesi i mbledhjes, pas këshillimit paraprak me personin ose entitetin që ka thirrur mbledhjen.

8.2 Nëse mbledhja thirret sipas kërkesës të së paku një të tretës (1/3) nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të kuvendit ose me kërkesë të Kryetarit të komunës, e drejta për të thirrë mbledhjen do të përfshijë edhe të drejtën për të propozuar rendin e ditës për mbledhjen e thirrur.

8.3 Pikat e rendit të ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme të thirrura nuk mund të ndryshohen në mbledhje të tillë.

8.4 Anëtari i kuvendit ose pjesëmarrësit nga publiku mund të kërkojnë që të futet ndonjë pikë tjetër në rendin e ditës gjatë mbledhjes së rregullt të kuvendit, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rendin e ditës është çështje urgjente me rëndësi publike. Pika e tillë e kërkuar bëhet pjesë e rendit të ditës nëse miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

## **Neni 9** **Procesverbali i mbledhjeve**

9.1 Procesverbalet e të gjitha mbledhjeve të mbajtura të kuvendit dhe komiteteve miratohen në mbledhjen e ardhshme në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe Rregulloren e Komunës për Përdorimin e Gjuhëve në Komunë.

9.2 Të gjitha dokumentet zyrtare të kuvendit përgatiten dhe publikohen në faqen elektronike të Komunës në gjuhët zyrtare të Komunës.

9.3 Procesverbali i mbledhjeve të kuvendit dhe komiteteve që kanë qenë të hapura për publikun mbahen në arkivë dhe duhet të jenë të qasshme për publikun kurdo që kërkohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

9.4 Procesverbali i mbledhjeve të Kuvendit dhe i mbledhjeve të Komiteteve të Kuvendit publikohet në faqen elektronike të Komunës në gjuhët zyrtare të Komunës.

9.5 Në procesverbalin e mbledhjes duhet të përmendet numri i pjesëmarrësve në votim dhe numri i votave për çdo vendim.

9.6 Audio inçizimi i seancës së Kuvendit të Komunës publikohet në faqen elektronike të Komunës.

**Neni 10**  
**Zgjedhja e kryesuesit**

10.1 Kuvendi zgjedh, në mbledhjen e tij përruese, kryesuesin nga radhët e anëtarëve, për të njëjtin mandat si anëtarët e kuvendit, me votim të fshehtë dhe me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të kuvendit të pranishëm dhe që votojnë.

10.2 Nëse kuvendi nuk ka mundësi ta zgjedhë kryesuesin në raundin e parë të votimit, procedura e njëjtë vazhdon derisa të zgjedhet një kryesues në ditën e njëjtë të mbledhjes përruese të kuvendit.

**Neni 11**  
**Zëvendës-kryesuesi për Bashkësi**

Kuvendi, në mbledhjen e tij përruese, shpall emrin e Zëvendës-kryesuesit për Bashkësi për t'u zgjedhur në kuvend, e cili ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve jo-shumicë.

**Neni 12**  
**Rendi gjatë mbledhjeve të kuvendit**

12.1 Kryetari, drejtorët, zyrtarët qeveritarë dhe personat tjerë që nuk janë anëtarë të kuvendit, por që janë të pranishëm në mbledhjen e kuvendit lejohen nga kryesuesi i mbledhjes që ta marrin fjalën dhe t'i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre në kuvend.

12.2 Kryesuesi i mbledhjes mund ta urdhërojë çdo anëtar të kuvendit ose ndonjë zyrtar që, sipas tij/saj ka përdorur gjuhë jo të përshtatshme, t'i tërheqë fjalët e tilla ose, nëse është e nevojshme, të ndërmarrë veprime në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje pune.

12.3 Debatit për ndonjë projekt-akt ose propozim të rëndësishëm, i dërguar përmes kryetarit ose ndonjë komiteti të rëndësishëm, duhet të jetë në pajtim me rendin e mëposhtëm:

- a) Paraqitësi i projekt-aktit ose propozimit të rëndësishëm;
- b) Nëse kryetari (ose zëvendës-kryetari) nuk është paraqitësi, drejtori i drejtorisë përkatëse;
- c) Kryesuesit e komiteteve të përhershme;
- d) Kryesuesit e komiteteve të tjera;
- e) Kryesuesit e grupeve tjera;
- f) Të gjithë anëtarët e tjerë të kuvendit kanë të drejtë të diskutojnë për projekt-aktin ose propozimin e rëndësishëm në rendin e paraparë nga kryesuesi i kuvendit;
- g) Në fund të debatit, paraqitësi i projekt-aktit ose propozimit të rëndësishëm ka të drejtë të përgjigjet dhe kryesuesi i kuvendit pastaj e mbyllë debatin.

12.4 Çdo anëtar i kuvendit, kryetari ose zëvendës-kryetari, drejtori ose ndonjë zyrtar tjetër që ka folur:

- a) Ka të drejtë t'i përgjigjet çdo anëtari ose drejtori që ka përmendur emrin e tij/saj apo diskutimin;
- b) E drejta për t'u përgjigjur në pajtim me pikën a) të paragrafit 4 të këtij neni kufizohet në dy (2) minuta menjëherë pas përfundimit të diskutimeve përkatëse;

- c) Kur anëtari i kuvendit ose zyrtari shfrytëzon të drejtën për t'u përgjigjur në pajtim me pikën a) lejohej kundërshtimi i paraqitësit fillestar deri në një (1) minut menjëherë pas përgjigjes.

12.5 Pa marrë parasysh paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, kryesuesi i mbledhjes mund ta lejojë ndonjë anëtar ose zyrtar që të ofrojë shpjegime lidhur me ndonjë diskutim të mëparshëm ose të ofrojë shpjegime që do ta ndihmonin debatin.

12.6 Anëtari i kuvendit mund të flasë vetëm një (1) herë në të njëjtin debat për ndonjë pikë të rendit të ditës, përveç rasteve në paragrafët 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

12.7 Gjatë mbledhjeve të kuvendit, koha e fjalimeve për pikat e rendit të ditës do të jetë si më poshtë:

- a) Shef i grupit në kuvend nuk mund të flasë më shumë se dhjetë (10) minuta;
- b) Anëtari i kuvendit nuk mund të flasë më shumë se pesë (5) minuta;
- c) Paraqitja e komitetit kryesor nuk mund të zgjasë më shumë se dhjetë (10) minuta;
- ç) Paraqitja e ndonjë komiteti tjetër nuk mund të zgjasë më shumë se dhjetë (10) minuta;
- d) Anëtarët e kuvendit nuk mund të diskutojnë për rendin e ditës më shumë se dy (2) minuta;
- dh) Anëtarët e publikut, nëse u jepet fjala, nuk mund të diskutojnë më shumë se dy (2) minuta.

### **Neni 13**

#### **Përdorimi i gjuhës në mbledhjet e kuvendit**

13.1 Gjuhët shqipe dhe serbe janë gjuhët zyrtare që përdoren në mbledhjet e kuvendit.

13.2 Në të gjitha mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve të tij ofrohet përkthim simultan apo konsektiv ofrohet për folësit e gjuhës joshumicë.

### **Neni 14**

#### **Sjellja e anëtarëve të kuvendit**

14.1 Askush në mbledhjen e kuvendit nuk duhet të ndërpresë ose zihet me fjalë me ndonjë person tjetër kur ky i fundit e ka fjalën.

14.2 Asnjë pjesëmarrës në mbledhjet e kuvendit nuk duhet të përdorë gjuhë fyese ose të pahijshme dhe të bëjë sulme personale ose veprime kundër ndonjë personi në mbledhje, ose të shpërndajë informata që dëmtojnë privatesinë e ndonjë personi tjetër, ose të sillt në ndonjë mënyrë jo të dinjitetshme, ose të çrregullojë punën e kuvendit.

### **Neni 15**

#### **Masat disiplinore**

15.1 Masat e mëposhtme disiplinore zbatohen ndaj çdo anëtari të kuvendit:

- a) Qortimi;
- b) Paralajmërimi disiplinor;
- c) Ndërprerja e fjalimit të tij/saj;
- ç) Përfshirja nga mbledhjet e kuvendit;
- d) Përfshirja nga pjesëmarrja në komitete, komisione dhe nga mbledhja e ardhshme e kuvendit.

15.2 Masat disiplinore në paragrafët d) dhe c) duhet të miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të kuvendit të pranishëm dhe që votojnë.

### **Neni 16**

#### **Masa disiplinore e qortimit dhe paralajmërimit**

16.1 Kur një anëtar shqipton fjalë fyese ose kur sjellja e tij/saj pengon punën ose rendin e mbledhjes së kuvendit ai/ajo paralajmërohet nga kryesuesi i mbledhjes.

16.2 Në rast kur anëtari, ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore nga paragrafi një (1) i këtij neni, dëshiron të ofrojë shpjegime për veprimet e tij/saj apo gjuhën e përdorur, ai/ajo do të flasë në fund të mbledhjes së kuvendit dhe jo më shumë se dy (2) minuta.

16.3 Kur anëtari përsëri shkeljen brenda të njëjtës mbledhje të kuvendit, pasi të qortohet, ose kur anëtari pengon seriozisht rendin në mbledhjen e kuvendit, atij/asaj i bëhet paralajmërim disiplinor nga kryesuesi i mbledhjes. Paralajmërimi i tillë disiplinor përfshihet në procesverbalin e mbledhjes së kuvendit.

16.4 Nëse anëtari i tillë, pas dhënies së paralajmërimit disiplinor, vazhdon me sjelljen e tillë ose fjalë jashtë pikave të rendit të ditës, ai/ajo do të ndërpritet.

16.5 Në rast kur shprehjet ose sulmet e bëra nga një anëtar në mbledhjet e kuvendit tërhiqen nga ai/ajo në mbledhjen e njëjtë dhe në rast se anëtari kërkon falje publikisht për sjelljen e tij/saj, kryesuesi i mbledhjes anulon masën e dhënë disiplinore nga paragrafi tre (3) i këtij neni.

### **Neni 17**

#### **Masat më të rrepta disiplinore**

17.1 Nëse anëtari, edhe pas paralajmërimit, vazhdon me të njëjtën sjellje penguese në të njëjtën mbledhje, kryesuesi e përjashton atë nga mbledhja e kuvendit për pjesën e mbetur të ditës. Nëse anëtari nuk pajtohet që të largohet nga salla, kryesuesi i kuvendit e ndërpret atë dhe ua paraqet udhëzimet e nevojshme shërbimeve të sigurisë në kuvend që të zbatohet masa e tillë.

17.2 Nëse anëtari shkakton dhunë ose provokon ndonjë çrregullim në mbledhjen e kuvendit ai/ajo përjashtohet nga pjesëmarrja në mbledhjen e ardhshme të kuvendit dhe komiteteve të tij.

17.3 Masa disiplinore e ndalimit të pjesëmarrjes në mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve shoqërohet me sanksione financiare të ndaljes së kompensimit për mbledhjen e tillë.

17.4 Masat disiplinore të marra nga kryesuesi i kuvendit nuk paragjykojnë masat tjera penale që mund të merren në pajtim me ligjet e zbatueshme në Kosovë ndaj shkelësit.

17.5 Nëse ndonjë çrregullim e pamundëson mbledhjen për atë ditë, mbledhja e kuvendit do të shtyhet nga kryesuesi për ndonjë ditë tjetër.

### **Neni 18**

#### **Masat kundër anëtarit të publikut**

Nëse anëtari i publikut pengon mbledhjen, kryesuesi duhet ta qortojë atë. Në rast se anëtari vazhdon të pengojë, kryesuesi merr masat në vijim:

1. Zyrtarisht e njofton anëtarin e publikut se do të pasojë masa disiplinore;
2. Udhëzon anëtarin që të tërhiqet nga një pjesë apo nga e tërë mbledhja;
3. Urdhëron anëtarin që ta lëshojë mbledhjen;
4. Urdhëron që nëpunësi i sigurisë ta shoqërojë anëtarin e publikut jashtë sallës së kuvendit; dhe
5. Shtyen mbledhjen për një datë tjetër.

### **Neni 19**

#### **Ndërprerja e mbledhjes së kuvendit**

19.1 Mbledhja e kuvendit ndërpritet në situatat e mëposhtme:

- a) Me qëllim të pushimit gjatë seancës;
- b) Kur gjatë mbledhjes prishet kuorumi për mbledhje;
- c) Kur gjatë mbledhjes numri i anëtarëve të pranishëm është nën numrin e kërkuar për të nxjerrë vendime;
- ç) Kur mbledhja zgjatë shumë dhe nuk mund të përfundohet ditën e njëjtë; dhe
- d) Kur prishet rendi i ditës dhe kryesuesi nuk ka mundësi ta udhëheqë mbledhjen në procedurë normale me masat disiplinore të parapara në nenin shtatëmbëdhjetë (18) të Rregullores së Punës.

19.2 Mbledhja e ndërprerë mbahet brenda pesë ditësh pune me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 20**

#### **Pyetjet për kryetarin dhe/ose drejtorët dhe përgjigjet gojore**

20.1 Çdo anëtar kuvendi mund t'i parashtojë pyetje kryetarit ose ndonjë drejtorit komunal.

20.2 Koha për t'iu përgjigjur pyetjeve është si më poshtë:

- a) Përgjigja gojore e kryetarit/drejtoratit nuk mund të zgjasë më shumë se dhjetë (10) minuta;
- b) Pyetjet që kërkojnë përgjigje gojore duhet të dorëzohen së paku *pesë (5) ditë pune dhe më së largu dhjetë (10) ditë pune para mbledhjes së kuvendit*. Askush nuk mund të dorëzojë më shumë se dy pyetje për kryetarin/drejtoratin. Pyetjet duhet të lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përkatës;
- c) Nëse kryesuesi i mbledhjes pranon pyetjet ato përfshihen në rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme. Nëse pyetjet refuzohen, personi që ka paraqitur pyetjet njoftohet me shkrim;
- ç) Pyetjeve u jepen përgjigje sipas rendit të dorëzimit;
- dh) Pasi u është dhënë përgjigje pyetjeve të parashtruara më parë, kryesuesi mundet, kur lejon koha, ta lejojë ndonjë anëtar të kuvendit që të parashtojë pyetje shtesë;
- d) Nëse për pyetjen që kërkon përgjigje gojore nuk ofrohet përgjigje brenda kohës së lejueshme, anëtari që ka parashtruar pyetjen do të njoftohet me shkrim ditën e njëjtë. Në rastet kur kjo nuk është e mundur, njoftimi bëhet jo më gjatë se dy (2) ditë nga data kur normalisht duhet përgjigjur pyetjeve.

#### **Neni 21**

#### **Çështjet urgjente**

21.1 Gjatë çdo mbledhje çdo grup i kuvendit ose anëtar që ka marrë pëlqimin paraprak të kryesuesit mund t'i propozojë kuvendit që ta shqyrtojë menjëherë ndonjë çështje urgjente me interes të veçantë publik.

21.2 Nëse kryesuesi dhe anëtarët e kuvendit konsiderojnë se çështja duhet të shqyrtohet menjëherë në kuvend, kryesuesi lejon grupin ose anëtarin përkatës ta arsyetojë propozimin e tij në kuvend dhe pas kësaj çështja të votohet.

21.3 Nëse kuvendi vendos ta shqyrtojë çështjen me shumicë votash, atëherë çështja shqyrtohet gjatë mbledhjes në fjalë.

#### **Neni 22**

#### **Propozimet procedurale**

22.1 Në çdo mbledhje të kuvendit, shefat e grupeve të kuvendit kanë të drejtë të propozojnë ndonjë nga çështjet e mëposhtme:

- a) Shtyerjen e mbledhjes;
- b) Debat për ndonjë pikë të rendit të ditës;
- c) Plotësojnë rendin e ditës ose ta paraqesin ndonjë çështje komitetin apo komision përkatës;
- ç) Përfundojnë debatin;

- d) Të kundërshtojnë nëse është shkelur apo jo Rregullorja e Punës; ose  
dh) Të kundërshtojnë nëse janë shkelur apo jo të drejtat e ndonjë anëtari të kuvendit, ashtu siç parashihen me ligjet e zbatueshme dhe Rregulloren e Punës.

22.2 Për pikat a) dhe b) të nenit 21.1 të Rregullores së Punës mbahet votim i menjëhershëm.

22.3 Për pikën c) formohet komitet apo komision, bashkë me arsyetimin lidhur me çështjen e tillë. Nëse kryesuesi i mbledhjes vlerëson se propozimi është në rregull, çështja debatohet menjëherë sipas procedurave të zbatueshme për debatet e tilla.

22.4 Pika d) debatohet menjëherë në pajtim me Rregulloren e Punës. Derisa të mbarojë votimi për këtë propozim, nuk mbahet asnjë propozim tjetër, përveç propozimeve sipas pikave a) dhe b).

22.5 Për pikën e) kryesuesi i mbledhjes tërheq vëmendjen se mbledhja duhet të mbahet sipas Rregullores së Punës.

22.6 Për pikën f) kryesuesi i kuvendit shqyrton propozimin dhe i raporton kuvendin brenda të njëjtës ose në mbledhjen tjetër lidhur me atë se a janë shkelur të drejtat e ndonjë anëtari apo jo.

#### **Neni xx**

#### **Procedura e hartimit, miratimit dhe implementimit të rregulloreve komunale**

1. Propozues për hartimin e rregulloreve komunale mund të jenë:
  - 2.1 Kryetari i Komunës;
  - 2.2 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës;
  - 2.3 Komitetet e Kuvendit të Komunës;
  - 2.4 Anëtari i Kuvendit të Komunës;
  - 2.5 Qytetarët e Komunës.
2. Propozimi për hartimin e një rregulloreje nga subjektet nga pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 duhet t'i dorëzohet me shkrim Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Propozimi duhet të përmbajë bazën ligjore dhe arsyeshmërinë e nxjerrjes së rregulloreve.
3. Kuvendi i Komunës shqyrton propozimet për hartimin e rregulloreve dhe me shumicë të votave të anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë vendos për miratimin apo refuzimin e propozimit.
4. Vendimin e Kuvendit të Komunës për hartimin e rregulloreve, Kryesuesi i Kuvendit ia dorëzon Kryetarit të Komunës për zbatim.
5. Kryetari i Komunës emëron grupin punues për hartimin e draft rregulloreve komunale të përbërë nga stafi profesional i Administratës së Komunës të cilët kanë eksperiencë në fushën në të cilën hartohet rregullorja. Në procesin e hartimit të rregulloreve komunale përfshihen edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe anëtarë të institucioneve të tjera relevante.
6. Zyra/Zyrtari Ligjor i Komunës është bartëse e procesit të hartimit të teknikës juridike të rregulloreve komunale dhe është përgjegjës për pajtueshmërinë e draft rregulloreve së hartuar me legjislacionin në fuqi.
7. Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së draft rregulloreve, të njëjtin ia përcjellë Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për procedim të mëtejshëm.

8. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, draft rregulloren e propozuar e përcjellë për shqyrtim në Komitetin për Politikë dhe Financa, në Komitetin për Komunitete dhe në komitetit relevante profesionale të Kuvendit.
9. Pas dhënies së pëlqimit nga komitetet nga paragrafi 8) i këtij Neni, Kuvendi i Komunës merr vendim për hedhje në diskutim publik të draft rregullores së propozuar.
10. Shqyrtimi publik i draft rregullores bëhet në pajtim me rregullat dhe procedurat e parapara në Rregulloren për Transparencë të Komunës.
11. Pas shqyrtimit publik të draft rregullores, Kuvendi i Komunës me shumicën e votave të anëtarëve që janë prezent dhe që votojnë vendos për miratimin ose jo të rregullores, përveç kur parashihet ndryshe me Ligj.
12. Të gjitha rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës publikohen në faqen elektronike të Komunës në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni xx

#### **Iniciativa e qytetarëve**

1. Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga Kuvendi i Komunës apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.
2. Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
3. Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës.
4. Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

Neni xx

#### **Përgatitja e Buxhetit të Komunës**

1. Kryetari, përkatësisht Drejtori përgjegjës për hartimin e Buxhetit të Komunës rregullisht e informon Komitetin për Politikë dhe Financa mbi procesin e hartimit të Buxhetit të Komunës, veçanërisht lidhur me përmbajtjen e qarkoreve buxhetore të lëshuara nga Ministria përgjegjëse.
2. Kryesuesi i Kuvendit, në bashkëpunim Kryetarin, kryesuesit e komiteteteve komunale, drejtorët, Njësia përgjegjëse për informim, zyra për barazi gjinore, udhëheqësja e Grupit të grave dhe përfaqësues të OJQ-ve, në muajin Maj të çdo viti kalendarik hartojnë Planin e veprimit për transparencë në procesin e hartimit të Buxhetit të Komunës.
3. Plani i veprimit për transparencë përmban:

- 2.1 Numrin, orarin dhe vendin e mbajtjes së dëgjimeve publike;
  - 2.2 Personat përgjegjës për përgatitjen e secilit dëgjim publik dhe panelistët e tyre;
  - 2.3 Orarin e takimeve me grupe të interesit me qëllim të konsultimit të tyre në procesin e hartimit të Buxhetit të Komunës, si: bizneset, OJQ-të, gratë, rinia, mediat etj;
  - 2.4 Materialet promovuese me qëllim të informimit të qytetarëve me procesin e hartimit të Buxhetit të Komunës, si: broshura, posterë, reklamat në mediat lokale.
4. Plani i veprimit për transparencë publikohet në faqen elektronike të Komunës.
  5. Para mbajtjes së dëgjimeve publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa përgatitë prezantimin e buxhetit komunal ku përfshihen informacione mbi shpenzimet buxhetore të vitit paraprak dhe alokimi i buxhetit për vitin e ardhshëm duke përfshirë edhe listën me projektet e propozuara për investime kapitale.
  6. Çdo projekt i investimeve kapitale duhet të shoqërohet me Planin për Përmirësimin e Shërbimeve Publike dhe duhet të përmbajë raportin e përgjithshëm mbi kënaqshmërinë e qytetarëve për shërbimet e ofruara të komunës dhe raportin për monitorimin e informacionit.
  7. Prezentimi nga pika 5 shfrytëzohet për të njoftuar qytetarët për detajet e buxhetit komunal gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike.
  8. Gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike, Njësia përgjegjëse për informim dhe Sekretaria e Kuvendit janë të obliguara që të hartojnë procesverbalin me kërkesat e qytetarëve.
  9. Njësia përgjegjëse për informim dhe Sekretaria Kuvendit, listën me kërkesat e qytetarëve ia dorëzojnë Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë përgjegjëse për hartimin e buxhetit.
  10. Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa analizojnë kërkesat e qytetarëve dhe vendosin për inkuorporimin e tyre në propozim buxhetin e Komunës.
  11. Kuvendi i Komunës deri më 30 shtator është i obliguar të miratojë buxhetin e Komunës për vitin e ardhshëm fiskal.
  12. Njësia përgjegjëse për informim e përgatitë komunikatën për media, ku njofton publikun për kërkesat e qytetarëve që janë inkuorporuar në propozim buxhetin e Komunës.
  13. Komunikata nga paragrafi 12 i këtij Neni publikohet në faqen elektronike të Komunës.

### **Neni 23**

#### **Nënshkrimi i akteve të miratuara nga kuvendi**

- 23.1 Aktet e miratuara nga kuvendi hyjnë në fuqi ditën e nënshkrimit të tyre nga kryesuesi i mbledhjes, apo, nëse ai nuk ka qenë i pranishëm në mbledhje, atëherë nënshkruhen nga anëtari që ka kryesuar mbledhjen në fjalë.
- 23.2 Kryesuesi i mbledhjes, apo anëtari që ka kryesuar mbledhjen i nënshkruan aktet e miratuara nga kuvendi brenda dyzetetë (48) orësh.
- 23.3 Të gjitha aktet komunale dorëzohen në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim administrativ të ligjshmërisë.

### **Neni 24**

#### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit**

24.1 Të gjithë anëtarët e kuvendit kanë të drejta të barabarta që të marrin pjesë në vendimet e kuvendit, pa marrë parasysh etnicitetin, racën, ngjyrën, gjininë, fenë, orientimet politike ose ndonjë bazë tjetër.

24.2 Çdo anëtar duhet të zotohet për të qenë pjesëmarrës aktiv në mbledhjet e kuvendit, në përgatitjet e të gjitha mbledhjeve dhe në ofrimin e mendimit për ndonjë pikë të rendit të ditës. Çdo anëtar informon kryesuesin e kuvendit çdo herë që ai/ajo nuk ka mundësi të jetë i pranishëm në ndonjë mbledhje dhe ofron arsyet për këtë, dhe e cila përfshihet në procesverbal.

24.3 Kuvendi është i hapur për sugjerime që vijnë nga përfaqësuesit e bashkësive joshumicë në komunën e Novobërds dhe i merr parasysh sugjerimet e tilla.

24.4 Kuvendi ndihmon pjesëmarrjen aktive të anëtarëve me nevoja të veçanta dhe ofron të gjithë ndihmën e nevojshme teknike për këtë qëllim.

24.5 Kuvendi inkurajon pjesëmarrjen aktive të anëtarëve femra gjatë dhe pas mbledhjeve të kuvendit dhe siguron që zëri i tyre dëgjohet.

24.6 Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive në veprimtarinë e kuvendit dhe inkurajimi i pakicave, femrave dhe njerëzve me nevoja të veçanta nuk konsiderohet si diskriminim ndaj përfaqësuesve tjerë.

## **Neni 25** **Konflikti i interesit**

25.1 Anëtarit të kuvendit i kërkohet t'i paraqesë të gjitha konfliktet e interesit menjëherë sapo të shfaqen në çdo mbledhje në të cilën anëtari është i pranishëm. Çdo anëtar mund të ofrojë informata për konfliktin e interesit të ndonjë antëari tjetër. Informatat duhet të shoqërohen me dëshim.

25.2 Para mbledhjes së parë, anëtarët e kuvendit shënojnë një deklaratë të plotë dhe të hapur interesat e tyre financiare në një regjistër publik që mbahet nga zyrtari i autorizuar i komunës. Anëtarët shënojnë çdo ndryshim në interesat e tyre financiare, sapo ato të ndodhin.

25.3 Anëtari i kuvendit, komitetit apo komisionit nuk merr pjesë procedurat vendimmarrëse dhe administrative të lidhura me ndonjë çështje në të cilën apo ajo ose ndonjë familjar i ngushtë apo i afërm ka interesa personale apo materiale.

25.4 Anëtari i kuvendit, komitetit ose komisionit mund të përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse nën paragrafin 1 të këtij neni me tërheqje vullnetare ose me vendimin e shumicës në mbledhjen e kuvendit.

25.5 Në rast se ka konflikt interesi e i cili nuk është vënë re gjatë procedurës vendimmarrëse, ose nëse anëtari i kuvendit, komitetit apo komisionit nuk e paraqet, vendimi i miratuar anulohet dhe vendoset sërish.

## **Neni xx**

### **Komunikimi elektronik**

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të pajisen me adresa elektronike zyrtare, të cilat duhet të përdoren për komunikim zyrtar.
2. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë të obliguar që brenda një (1) muaji nga fillimi i mandatit të tyre në Kuvend, të pajisen me adresa elektronike zyrtare.
3. Adresat elektronike të anëtarëve të Kuvendit duhet të publikohen në faqen elektronike të Komunës.

**Neni 26**  
**Sekretariati i Kuvendit**

26.1 Sekretariati i kuvendit komunal është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale, administrative dhe teknike kuvendit dhe anëtarëve të tij.

26.2 Sekretariati i kuvendit caktohet nga administrata e komunës.

**Neni 27**  
**Plotësimi i Rregullores së Punës së Kuvendit**

27.1 Kryesuesi i kuvendit rishikon Rregulloren e Punës dhe kohë pas kohe i propozon kuvendit amendamente të cilat i konsideron të nevojshme.

27.2 Çdo grup ose anëtar i kuvendit, i mbështetur nga së paku një e treta (1/3) e anëtarëve të kuvendit, mund të paraqes propozim për plotësimin e kësaj rregulloreje pune.

27.3 Vendimi për plotësimin e Rregullores së Punës merret nga kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

**Neni 28**  
**Hyrja në fuqi**

Rregullorja e Punës hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga kryesuesi i mbledhjes.  
Me datë Prill 2013 Kryesuesja e Kuvendit Komunal  
Novolirëde Shefkije Mehmeti

